



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Departamenti i Prokurimit

Komuna e Lipjanit: datë, 15/09/2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Lipjanit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës: 12/09/2022, të parashtruar nga *Operatori ekonomik Quality Asphalt SH.P.K, Ferizaj të cilën e përfaqeson Endrit Krasniqi*, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)-Ritenderim, me nr te prokurimit 613-613-22-7288-5-2-1, nxjerr këtë ;

VENDIM

I Refuzohet: Kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit Ekonomik *Quality Asphalt SH.P.K*, të dt. 12.09.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)-Ritenderim, me nr te prokurimit 613-613-22-7288-5-2-1.

Vërtetohet: Vendimi i Autoritetit Kontraktues i datës.02.09.2022, i publikur në E-Prokurimi.

1. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të lartëpërmendur.
2. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

Arsyetim

Operatori Ekonomik *ekonomik Quality Asphalt SH.P.K, Ferizaj të cilën e përfaqeson Endrit Krasniqi*, lidhur me aktivitetin e prokurimit: Rikonstruimi i rrugëve në Ribar të Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)-Ritenderim, me nr te prokurimit 613-613-22-7288-5-2--1, Autoriteti Kontraktues ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

1. Pretendimi juaj i parë:

AK Komuna Lipjan, e ka shpërblyer me kontratë OE BAGERI, i cili OE nuk është i përgjegjshëm sipas kritereve të kërkuara sepse gjatë qasjes që kemi pasur rezultoi se AK e ka shpërblyer me kontratë një OE i cili ka bërë mashtrime ndaj AK-së konkretisht dyshohet në falsifikim të kontratës – nënshkrimit të inxhinierit e që do ta paraqesim me argument.

Sqarim:

Lidhur me inxhinierin e gjeodezisë Luan Abazi, shihet se në kontratën e nënshkruar në vend të inxhinierit ka bërë mashtrim apo falsifikim, sepse në pjesën që nënshkruan inxhinieri në dy vende shkruan nënshkrimi, pra njëra ka shkronja me të vogla dhe tjetra me të mëdha, ku në si OE duke e parë si dokument të dyshimt dhe që shihet hapaz se ka manipuluar OE i rekomanduar me kontratën e tij.

Si me poshtë e gjentë bashkëgjithë kontratën e inxhinierit në fjalë.

Komisioni i vlerësimit të ofertave e ka obligim ligjor që gjatë vlerësimit të vërtetë rastet e dyshimita dhe t'i paraqes neper organet kompetente, sepse e gjithë përgjegjësia bie mbi komisionin e vlerësimit dhe zyrën e prokurimit që nuk e kanë vërtetuar një gjë të tillë e që është shpallur e lehtë për tu vërtetuar.

Me poshtë po e paraqesim kontratën e cila është e dyshimt dhe që e njëjta duhet të verifikohet sa më para që është e mundur nga organet kompetente.

Faqja e parë e kontratës, ku bëhet fjalë për inxhinierin e gjeodezisë e cila kontratë dyshihet në falsifikim apo manipulim..

1.2 Përgjigjeje në pretendimin e parë:

Përgjigjeja nga OE:

Përgjigjeje në pretendimin e juaj: AK sipas dispozitave ligjore rrespektivisht nenit 72, të LPP-se, kërkuar sqarimet shpesh nga Kompania në fjalë po ashtu edhe nga Inxhinieri Luan Abazi, të cilët kanë dërguar edhe deklaratat e tyre.

 Reply  Reply All  Forward



NPSH Bageri <bagerinps@gmail.com>

Bekim G. Shabani

Tue 2:55 PM

Re: Kerkese

Retention Policy: DelFiveYOldEm (5 years)

Expires: 9/12/2027

Te nderuar ne pranuam emailin tuaj lidhur me sqarimin e kontrates se gjeodetit Luan Abazi.

Ne ju njoftojme se kemi marrveshje sipas kontrates ne DT te cilen e keni dhe se kjo kontrate eshte e lidhur me pajtimin e dy paleve nenshkruese, per qdo dilem tuajen ju mund te kontaktoni edhe me Gjeodefin permes telefonit ne numrin 044-474-285 ose ne emailin Luanabazi1@gmail.com.

Paraprkishte Faleminderit.

On Tue, Sep 13, 2022 at 2:31 PM Bekim G. Shabani <bekim.g.shabani@rks-gov.net> wrote:

I nderuar!

Konfirmimi nga Inxhinieri Luan Abazi

Reply Reply All Forward



Luan Abazi <luanabazi1@gmail.com>

Belim G. Shabani

10:55

Re: Pershendetje!

Retention Policy: Delete Old Emails (5 years)

Expires: 9/13/2027

Pershendetje i nderuar,

Une e konfirmoj qe kam kontrat mbi veper (per pune specifike) me kompanin NPSH-Bageri Ferizaj per projektin Rikonstruimi i rruges ne Ribar te Madh (rr. Vehbi Kozhani e Beqir Duriqi)-Ritenderim, me nr prokurimi: 613-22-7288-5-2-1. Dokumentat e perdorura jane ne rregull dhe me pelqimin tim.

Shendet dhe pune te mbar.

Pretendimi juaj i pare eshte i pa bazuar!

2.Pretendimi juaj i dyte:

Poashtu gjate qasjes qe kemi pasur kemi verejtur se OE i rekomanduar eshte i papergjegjshem, sepse ne marreveshjen e bashkangjitur me IZOLACIJA SHKUP, per pajisjen Cilinder HAMM HD 14 TT me peshe 3.5 Ton, e nenshkruar me dt.22.07.2022 ne mes te paleve BAGERI dhe IZOLACIJA, kjo pajisje nuk eshte konform LPP-se dhe dispozitave ligjore sepse sipas nenit 13 te LPP-se qe sipas dispozitave ligjore gjuhet zyrtare sipas LPP-se jane Gjuha shqipe, serbe ose angleze. Kurse OE e ka bashkangjitur faturen ne gjuhen maqedone, e qe bie ne kundërshtim me nenin 13 te LPP-se.

Paragrafi 4 i nenit 13 te LPP-se thote:

Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

2.1 Përgjigjeje në pretendimin e dytë:

